


**DOKUMENT TEMATIK**

**Rimendimi i  
angazhimit ndërmjet  
shërbimeve të  
zbulimit dhe  
shoqërisë civile**



### **Rreth këtij dokumenti tematik**

Ky dokument tematik u hartua nga Divizioni i DCAF për Evropën dhe Azinë Qendrore. DCAF dëshiron të falënderojë Departamentin Federal të Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sportit (DDPS) të Konfederatës Zvicerane dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme Norvegjeze për mbështetjen e tyre pa rezervë në realizimin e këtij botimi.

### **Shënim**

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë opinionet ose pikëpamjet e Departamentit Federal të Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sportit të Konfederatës Zvicerane ose të Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze.

### **Rreth DCAF**

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë është e përkushtuar në përmirësimin e sigurisë së shteteve dhe qytetarëve të tyre brenda një kuadri të qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Që nga themelimi i tij në vitin 2000, DCAF ka kontribuar në arritjen e paqes dhe zhvillimit më të qëndrueshëm duke ndihmuar shtetet partnere dhe aktorët ndërkombëtarë që mbështesin këto shtete, për të përmirësuar qeverisjen e sektorit të tyre të sigurisë përmes reformave gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse. Ai krijon produkte inovative të njohurive, promovon norma dhe praktika të mira, ofron këshilla ligjore dhe politike dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve të interesit në sektorin e sigurisë shtetërore dhe joshtetërore.

DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance  
Maison de la Paix Chemin Eugène-Rigot 2E CH-1202  
Geneva, Switzerland

Tel: +41 22 730 94 00

info@dcaf.ch www.dcaf.ch

Twitter @DCAF\_Geneva

ISBN: 978-92-9222-581-0

# RIMENDIMI I ANGAZHIMIT NDËRMJET SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT DHE SHOQËRISË CIVILE

## Hyrje

Në vitet e fundit, koncepti i mbikëqyrjes demokratike është zgjeruar për të përfshirë rolin që luan shoqëria civile në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Përveç kësaj, siguria nacionale dhe në veçanti, komuniteti i zbulimit në përgjithësi, shihen se janë në kuadër të fushës ekskluzive të pushtetit ekzekutiv. Në rastet kur shoqëria civile luan një rol në mbikëqyrjen e sektorit të zbulimit, e bën këtë në përgjithësi përmes mjeteve tradicionale të mbikëqyrjes publike, siç është përfaqësimi. Përderisa ky dokument i shkurtër tematik nënvizon rëndësinë e strategjive të tilla, i njëjti sugjeron se nën kushte të caktuara, ata mund të plotësohen nga qasjet tjera. Ky dokument detajon kushtet nën të cilat mund të përputhen interesat e shërbimeve të zbulimit dhe shoqërisë civile dhe prezanton disa strategji për shërbimet e zbulimit që i nënshtrohen proceseve të reformave për t'u angazhuar me shoqërinë civile. Dialogu i tillë mund të ketë disa përfitime: nga përmirësimi i cilësisë të punës të shërbimeve të zbulimit në identifikimin e mënyrave për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe menaxhimin e aktivitetit të zbulimit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se në përgjithësi roli i shoqërisë civile dhe shërbimeve të zbulimit duhet të ndahet rreptësisht për të siguruar pavarësinë e të parës, dhe se vetëm në kushte të caktuara shërbimet e zbulimit duhet të shqyrtojnë angazhimin e shoqërisë civile.

Ky dokument tematik përbëhet nga tre pjesë: Pjesa e parë, shpjegon arsyen kryesore për të ekzistuar dialogu ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit. Pjesa e dytë, dokumenti fokusohet në faktorët kontekstual që ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë civile dhe shërbimeve të zbulimit, dhe detajon kushtet nën të cilat mund të konsiderohet dialogu ndërmjet shërbimeve të zbulimit dhe shoqërisë civile. Përfundimisht, dokumenti paraqet disa strategji të cilat mund t'i ndjekin shërbimet e zbulimit për të përforcuar dialogun me shoqërinë civile.

# 1. Arsyet kryesore për të ekzistuar dialogu ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit

Më konkretisht, dialogu ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit, mund të:

- Shmang politizimin: Dialogu kufizon aktivitetet e pushtetit ekzekutiv që mund të çojë në politizimin shërbimeve të zbulimit dhe mundësinë për keqpërdorim për qëllime personale politike. Politikbërësit mund të neglizhojnë produktet e shërbimeve të zbulimit të cilat nuk konfirmojnë agjendën e bartësve të politikës, dhe angazhimi i shoqërisë civile mund të përforcojë objektivitetin kundrejt ndikimit dhe bindjes të politikës.
- Risë vetëdijen për nevojat e shoqërisë civile. Shoqëria civile posedon ekspertizë teknike që rrallëherë shfrytëzohet nga shërbimet e zbulimit. Organizatat e specializuara të shoqërisë civile (OSHC), shpesh përbëhen nga ish praktikantë, mund të kontribuojnë për të analizuar kërcënimet e sigurisë nacionale, dhe të formulojnë propozime që u përgjigjen nevojave të sigurisë dhe sfidave të shoqërisë. Ata mund të analizojnë kornizat ligjore dhe institucionale që rregullojnë aktivitetin e shërbimeve të zbulimit, veçanërisht në lidhje me klasifikimin dhe mbikëqyrjen e informatave.
- Risë legjitimitetin dhe besimin në shërbimet e zbulimit: Krijimi i platformave për dialog ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit mund të përmirësojë legjitimitetin dhe kredibilitetin e kësaj të fundit. OSHC mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e vetëdijes shoqërore dhe mirëkuptimin e rolit që luajnë shërbimet e zbulimit në sigurimin e sigurisë nacionale. Në veçanti, OSHC të specializuara mund të kontribuojnë në zhvillimin e politikave të komunikimit strategjik të cilat sigurojnë që shërbimet e zbulimit të komunikojnë natyrën e punës të tyre para qytetarëve.
- Lehtësojë profesionalizmin dhe integritetin e shërbimeve të zbulimit: OSHC që merren me etikën dhe menaxhimin e sektorit të sigurisë mund të kontribuojnë me ekspertizën e tyre për të zhvilluar kornizat e etikës për shërbimet e zbulimit, në veçanti për kodet e etikës dhe sjelljes.
- Ofrojë një platformë për të trajtuar ankesat historike: Në shumë shtete në tranzicion, shërbimet e zbulimit duhet të përballen me të kaluarën të karakterizuar nga një marrëdhënie konfrontuese me shoqërinë. Në disa raste, shërbimet e sigurisë akuzohen për kryerjen e padrejtësive historike, dhe shihen me dyshim nga

shoqëria civile. Ofrimi i platformës për dialog të ndërsjellë me shoqërinë civile mund të ndihmojë për të tejkaluar këto ankesa historike dhe mund të lehtësojë komunikimin me shoqërinë civile mbi natyrën dhe përparimin e proceseve për reformën e shërbimeve të zbulimit.

## 2. Faktorët kontekstual

Konteksti në të cilin funksionojnë shërbimet e zbulimit ndryshon nga shteti në shtet, ashtu siç ndryshon edhe roli i shoqërisë civile. Duke patur parasysh këtë, aftësia e shërbimeve të zbulimit që të angazhohen me OSHC varet nga katër faktorë.

Faktorët kontekstual	Shpjegimi	Mënyrat për të shqyrtuar
Baza ligjore që rregullon shërbimet e zbulimit	Legjislati i sektorit të sigurisë shpesh përcakton mënyrat përmes të cilave mund të vendoset dialogu me qytetarët. Ne rastet kur legjislati nuk përmban norma ose mekanizma të tillë, angazhimi ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit zakonisht realizohet aty për aty ( <i>ad hoc</i> ).	A përmban legjislati mekanizma për të mundësuar angazhimin sistematik ndërmjet shoqërisë civile dhe komunitetit të zbulimit? Kjo mund të përfshijë, për shembull faktin nëse Këshilli Publik përbëhen nga ekspertët e shoqërisë civile që kanë specializuar në çështjet e zbulimit? Nëse jo, a parasheh legjislati krijimin e organeve për mbikëqyrje nga ekspertët?
Baza ligjore për qasje në informata (të klasifikuara)	Sipas ligjit, informatat mund të jenë të klasifikuara apo të konsiderohen si informata të rëndësishme publike, dhe rrjedhimisht të jenë të disponueshme për konsum nga shoqëria civile.	A përmban legjislati mbi sekretet shtetërore/informatat e klasifikuara udhëzime dhe procedura të qarta për deklasifikimin e informatave? A parasheh ligji procedura të qarta, transparente dhe qashe për qasjen në informata të rëndësishme publike?
Instrumentalizimi politik	Organizatat mund të përfaqësojnë interesin politik apo të promovojnë agjendat e fshehta	A mbesin neutral partnerët e mundshëm dhe a u shërbejnë komuniteteve?

<p>Interesat e mbiverndosura</p>	<p>Në përgjithësi, shoqëria civile dhe shërbimet e zbulimit duhet të mbesin rreptësisht të ndarë. Në shtetet në tranzicion, shërbimet e zbulimit duhet të shqyrtojnë vetëm angazhimin me shoqërinë civile në kushte specifike. Përndryshe, mund të rrezikohet pavarësia e kësaj të fundit.</p>	<p>A janë të përkushtuar shërbimet e zbulimit në reforma?</p> <p>A janë interesat dhe motivet pas proceseve të reformave të sinqerta? Në situatat e tilla, shërbimet e zbulimit duhet të përfshijnë shoqërinë civile në procesin e reformave përmes, për shembull, mbështetjes në ekspetizën e institucioneve akademike, dhe organizatave të specializuara të shoqërisë civile. Në mungesa të proceseve të tilla të reformave, shërbimet e zbulimit duhet të vazhdojnë që të kërkojnë të angazhojnë shoqërinë civile, por në një mënyrë që nuk rrezikon pavarësinë e tyre. Kjo mund të kërkojë organizimin e tryezave të rrumbullakta publike dhe diskutimeve për të diskutuar sfidat e përbashkëta të sigurisë dhe shqetësimet e shoqërisë civile, si dhe sigurimin e informatave mbi aktivitetet e shërbimeve të zbulimit.</p>
----------------------------------	--	--

### 3. Format e dialogut ndërmjet komunitetit të zbulimit dhe shoqërisë civile

Tradicionalisht, shoqëria civile ka ushtruar mbikëqyrje mbi sektorin e sigurisë, duke përfshirë sektorin e zbulimit, përmes metodave të ndryshme. Këto përfshijnë: hulumtimin dhe informatat, që përbëjnë një nga metodat më të rëndësishme përmes të cilave mund të shqyrtohet baza ligjore dhe sjellja e shërbimeve të zbulimit; ngritja e vetëdijes, që lidhet me sigurimin e informatave dhe është thelbësore për edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre kundrejt sektorit të sigurisë dhe për atë se si duhet të funksionojë një shërbim i zbulimit i cili është llogaridhënës dhe i përgjegjshëm; dhe të tjerët, duke përfshirë përfaqësimin, trajnimin dhe monitorimin. Strategjitë e përmendura më sipër janë kritike për sigurimin e mbikëqyrjes efektive

publike të sektorit të sigurisë. Megjithatë, ato në përgjithësi janë të inicuar nga shoqëria civile, në vend se nga shërbimet e zbulimit. Kjo mund të veprojë për të liruar këtë të fundit për të vendosur dialogun me shoqërinë civile dhe për të parandaluar atë që të bazohet në ekspertizën që mund të ofrojë shoqëria civile. Derisa qasjet e tilla janë meritore, ata kufizohen në aftësinë e tyre për të lehtësuar dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe shërbimeve të zbulimit.

Ekzistojnë disa strategji të cilat mund të shfrytëzohen nga shërbimet e zbulimit për të përmirësuar dialogun me shoqërinë civile. Qëllimi kryesor i qasjeve të tilla është që të zhvendosen marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorit të zbulimit përtej formave tradicionale të mbikëqyrjes, drejtë përmirësimit të dialogut. Në një kombinim me format tradicionale të mbikëqyrjes, qasjet e tilla mund t'i ekspozojnë shërbimet e zbulimit ndaj potencialit të pashfrytëzuar të shoqërisë civile; mund të rrisin besimin publik, dhe të veprojnë si mekanizëm për parandalimin e konfliktit duke siguruar një platformë për të adresuar ankesat historike dhe për të komunikuar proceset e reformave të zbulimit. Kjo përpjekje përqipet që të zërthejë perceptimin e shoqërisë civile dhe shërbimeve të zbulimit si 'kundërshtar' duke marrë parasysh kontekstet në të cilat përputhen synimet e tyre të përbashkëta dhe qëllimet e përbashkëta. Më poshtë janë detajuar disa strategji të cilat mund të përdoren, apo të cilat mund të përfaqësohen ndryshe nga shërbimet e zbulimit. Kur ka mundësi, gjithashtu ofrohen raste studimore.

#### • **Këshillat për mbikëqyrje civile**

Disa shtete kanë shqyrtuar krijimin e trupave për mbikëqyrje civile, që përbëhen nga përfaqësuesit e shoqërisë civile të cilët kanë kompetenca sipas ligjit që të mbikëqyrin shërbimet e zbulimit. Si pjesë e kompetencave të tyre, këto trupa duhet të vendosin kanale të drejtëpërdrejta të komunikimit me shërbimet e zbulimit. Ekzistojnë dy shembuj të institucioneve të tilla - Këshilli Kroat për mbikëqyrje civile të shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit dhe në Maqedoninë e Veriut është Këshilli për mbikëqyrje civile. Në të dy rastet, këto trupa nuk janë tërësisht të pavarur, dhe janë llogaridhënës para parlamentit. Nëse do të themeloheshin si një trup i pavarur, një institucion i tillë do të ishte i lirë nga përkatësia në partitë politike, dhe kështu do të ishin më objektiv në analizën e tyre dhe ndërveprimin e shërbimeve të zbulimit. Kjo mund të shërbejë potencialisht si mënyrë për të përmirësuar dialogun dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet shoqësisë civile dhe shërbimeve të zbulimit.

Derisa themelimi i këshillit për mbikëqyrje civile do të kërkojë miratimin e amendamentit(eve) ligjore, një qasje alternative mund të përfshijë gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile në trupat për mbikëqyrje nga ekspertët. Në kuadër të sferës euro-atlantike, trupat e tillë janë

të shpërndarë gjëresisht,<sup>1</sup> por zakonisht përfshijnë persona me ekspertizë ligjore dhe juridike (ish gjykatës, prokuror, politikan, zyrtarë të lartë për zbatimin e ligjit). Zgjerimi i kësaj kërkesë për të përfshirë përfaqësuesit e organizatave të specializuara të shoqërisë civile, si në rastin e Këshillit Kroat për mbikëqyrje civile, do të mundësojë angazhim të shoqërisë civile pa patur nevojë që të miratohen amendamente ligjore.

## Rast studimor: Këshilli Kroat për mbikëqyrje civile

Ligji kroat për sistemin e zbulimit-sigurisë i vitit 2006, parasheh tre organe për mbikëqyrje: komisioni i përhershëm për mbikëqyrje parlamentare, organi për mbikëqyrje administrative dhe Këshilli për mbikëqyrje civile (KMC). Kompetencat e KMC janë të dyfishta: sigurimi i legalitetit në aktivitetet e zbulimit dhe përdorimi legjitim i kompetencave të veçanta. KMC përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur me mandat prej katër vitesh nga parlamenti pas një procesi të hapur të përzgjedhjes. Ai është llogaridhënës para parlamentit, me personel që më parë ka qënë në shërbime të zbulimit, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, dhe puna e tij mbikëqyret nga komisioni parlamentar për mbikëqyrje të zbulimit.

Këshilli ka luajtur një rol të rëndësishëm në disa raste të profilit të lartë të keqpërdorimit të pushtetit të veçantë. Në dy raste në vitet 2004 dhe 2007, procedurat e veçanta gjyqësore të inicuar nga viktimat e keqpërdorimit kanë pranuar kontributin e vlefshëm të Këshillit në vertetimin e fakteve dhe vendimeve të gjykatës.

Këshilli për mbikëqyrje civile që atëherë ka marrë një rol më plotësues nga ai i parlamentit. Ai kryesisht heton ankesat individuale nga qytetarët, me raste të profilit të lartë që në përgjithësi adresohen nga komisionet për mbikëqyrje parlamentare. KMC ka kompetenca që të shqyrtojë çdo dokument dhe të intervistojë zyrtarët e zbulimit.

### • Tryeza e rumbullakët

Shërbimet e zbulimit mund të shqyrtojnë thirrjen e diskutimeve në tryeza të rumbullakta me organizatat e shoqërisë civile. Përderisa

1 Këto përfshijnë, për shembull: Belgjikën – Komisioni i përhershëm për kontrollin e agjencive të zbulimit; Holandën – Komisioni për kontrollin e shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë; Portugalinë – Këshilli për mbikëqyrje të sistemit të zbulimit në Republikën e Portugalisë, dhe Suedinë – Komisioni për mbrojtjen e sigurisë dhe integritetit



një gjë e tillë në praktikë mbetet e rrallë, mundëson një mundësi unike për të ndërtuar besimin ndërmjet zyrtarëve të zbulimit dhe shoqërisë civile. Kjo mund të ndihmojë që shoqëria civile të kuptojë çështjet e gjëra që janë në rrezik dhe ka mundësi të shqyrtojë perspektivën e agjencive të zbulimit. Në Kroaci, shërbimi i zbulimit ka prezantuar diskutimet vjetore në tryeza të rrumbullakta ndërmjet zyrtarëve të lartë të zbulimit dhe grupeve të shoqërisë civile. Kjo nismë është parë pozitivisht nga të dy anët, dhe është argumentuar se rezulton në transparencë më të madhe nga ana e shërbimeve të zbulimit, me rritje në numrimin e dokumenteve të lëshuara publikisht dhe informatave të deklasifikuara.

Përndryshe, në Shtetet e Bashkuara, Zyra e lirive, privatësisë dhe transparencës thirr diskutimet me shoqërinë civile pas zbulimit të dokumenteve të reja të deklasifikuara nga Drejtori i zbulimit nacional. Kjo ofron kontekst në dokumentacion dhe i mundëson shoqërisë civile të bëjë pyetje të ndërlydhura. Përveç kësaj, diskutimet e tilla ofrojnë një mundësi për të adresuar shqetësimet që lidhen me mbikëqyrjen dhe përdorimin e metodave tjera ndërhyrëse nga shërbimet e zbulimit, dhe i ofrojnë shoqërisë civile një mundësi për të prezantuar perspektivën e tyre mbi këto çështje. Një nivel i caktuar i angazhimit gjithashtu mund të vëzhgohet në Francë, me zyrtarët e zbulimit të pranishëm gjatë ngjarjes “La Fabrique Défense”, për të “informuar, diskutuar dhe debatuar” çështjen e sigurisë me publikun e gjërë.

#### • **Sigurimi i informatave nga shërbimet e zbulimit**

Botimi i raporteve vjetore të deklasifikuara mbi aktivitetet e shërbimeve të zbulimit janë bërë një praktikë e shpërndarë gjërësisht për të lehtësuar ndarjen e informatave me shoqërinë civile. Për shembull, Byroja letoneze për mbrojtjen e kushtetutës boton raportet vjetore mbi aktivitetet e saj, ndërsa Agjencia kroate lejon vizita në hapësirat e saj nga studentët, grupet e shoqërisë civile dhe delegacionet ndërkombëtare, siç janë, mes të tjerash anëtarët e komisioneve për mbikëqyrje parlamentare. Raportet vjetore gjithashtu janë një praktikë e vendosur në Francë, Sllovaki dhe Republikën Çeke.

Përveç kësaj, procedurat e qarta dhe transparente për deklasifikimin e informatave janë të rëndësishme për lehtësimin e angazhimit të shoqërisë civile në çështjet e zbulimit. Për shembull, komuniteti francez i zbulimit ka konsultuar disa historian dhe gazetarë në menaxhimin e deklasifikimit progresiv të arkivës të tyre.

#### • **Raportet dhe rekomandimet e ekspertëve nga OSHC**

Organizatat e shoqërisë civile shpesh fokusohen në temat specifike dhe fushat e shqetësimit publik siç janë liritë civile, privatësia, ose mbikëqyrja onlajn (përgjimi i komunikimit personal). Analizat, raportet dhe rekomandimet e tyre mund t’u ndihmojnë agjencive të zbulimit për të përmirësuar funksionimin dhe operimin e tyre institucional.

### • **Vendosja e bashkëpunimit me komunitetet akademike**

Një tjetër mënyrë për të lehtësuar angazhimin ndërmjet shërbimeve të zbulimit dhe shoqërisë civile është nxitja e marrëdhënieve me komunitetin akademik. Një qasje e tillë mund të përfshijë sigurimin e punëve praktike për studentët në universitete. Për shembull, shërbimi çek i zbulimit (BIS - Bezpečnostni Informační Služba) që nga viti 2017 ka ofruar tre raunde të pozitive të punëve praktike për studentët në universitet. Në vitin 2018, BIS gjithashtu ka organizuar një ligjeratë në bashkëpunim me Fakultetin juridik të Plzen në temën ‘Statusi ligjor dhe funksionimi i BIS në kuadër të sistemit çek të sigurimit.’

Një shembull tjetër përfshin atë të Departamentit shtetëror të sigurisë në Republikën e Lituaniës, që ka inicuar një projekt të përbashkët me Universitetin Vilnius me titull “Zyrtar i zbulimit për një javë”. 60 studentë ishin informuar për sfidat e sigurisë nacionale lituaneze dhe specifikat e aktiviteteve të zbulimit. Një shembull tjetër ka të bëjë me Agjencinë franceze të zbulimit, e cila në raste të ndryshme ka organizuar sfida shpërblyese për kriptologjinë e shkollave të mesme.

### • **Organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje**

Shërbimet e zbulimit mund të rrisin vetëdijen publike të punës të tyre duke organizuar ose marrë pjesë në ngjarje publike. Për shembull, Departamenti shtetëror i sigurisë i Republikës së Lituaniës ka mbajtur ngjarje të ndryshme publike që shënojnë 100 vjetorin e “rivendosjes së shtetësisë”. Këto përfshijnë ngjarjet që kishin të bëjnë me krentrimin e figurave të rëndësishme historike në komunitetin lituanëz të zbulimit, dhe zhvillimin e dokumentarit me titull “Fronti në hije”.

Komuniteti francez i zbulimit gjithashtu angazhohet në kontaktet me publikun respektivisht qytetarët, për shembull përmes sigurimit të intervistave për gazetarët e akredituar dhe duke organizuar anketa për matjen e mendimit publik. Në Shtetet e Bashkuara, zyrtarët e Agjencisë të zbulimit të mbrojtjes rregullisht raporton në aktivitetet e tyre.

### • **Vendosja e platformave onlajn**

Një nga pengesat kryesore të angazhimit sistematik ndërmjet shoqërisë civile dhe shërbimeve të zbulimit është mungesa e platformës përmes të cilës mund të mirëmbahet komunikimi i rregullt. Aktualisht, mbetet një praktikë e zakonshme për organizatat e shoqërisë civile për të publikuar raporte mbi agjencitë e zbulimit, por pa ndonjë platformë të fundit që të ndjek çështjet dhe shqetësimet e identifikuara. Vendosja e platformave digjitale përmes të cilave shërbimet e zbulimit dhe shoqëria civile mund të komunikojnë do të nxiste marrëdhëniet më të mira dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. Gjatë kohës, platformat e tilla digjitale mund të çojnë në formimin e komunitetit të praktikës ndërmjet përfaqësuesve të OSHC mbi çështjet

e zbulimit, me të cilët shërbimet e zbulimit mund të diskutojnë çështjet e ndërlidhura.

• **Qasjet inovative në ndarjen e informatave**

Teknologjia *Blockchain* është baza për një lloj të ri të komunikimit onlakjn që mundëson që informimi digjital të shpërndahet por të mos kopjohet. Informatat që mbahen nga *blockchain* ekzistojnë si një bazë e ndarë e të dhënave pa kontroll nga një entitet i vetëm. Agjencitë e zbulimit në vitet e fundit kanë filluar që të shqyrtojnë se si teknologjia *blockchain* mund të kontribuojë për të siguruar ruajtjen e të dhënave. Koleksionet (librat) e shpërndara(ë) të llogarive financiare mundësojnë ndarjen e bazave të të dhënave me një rrjet të aktorëve në lokacione, pozita gjeografike dhe institucione të ndryshme në të cilat të gjithë pjesëmarrësit në rrjet kanë kopjen e tyre identike të këtyre koleksioneve të llogarive financiare. Çdo ndryshim në këtë koleksion do të pasqyrohet në të gjithë kopjet. Përmes lidhjes platformës të sigurtë dhe neutrale, *blockchain* hap derën për ndërveprim të shpejtë dhe të drejtëpërdrejtë ndërmjet shërbimeve të zbulimit dhe OSHC. Informacioni dhe rezultatet bëhen tërësisht transparente dhe të qasshme për të gjithë pjesëmarrësit. Të gjithë përdoruesit do të bëhen pronarë të informatave, dhe decentralizimi i ruajtjes të skedarëve në internet sjell përfitime të qarta. Llojet e aseteve të ruajtura aty mund të ndryshojnë dhe teknologjia *blockchain* mund të përdoret për të inkorporuar rregullat, kontaktet e mençura, nënshkrimet digjitale, ose mjetet tjera. Përdorimi i kësaj teknologjie nga shërbimet e zbulimit në marrëdhëniet e tyre me shoqërinë civile mund të sigurojë një mënyrë të sigurtë për të dy palët për të bashkëpunuar dhe ndarë informata.

**DCAF** Geneva Centre  
for Security Sector  
Governance

**[www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)**

**DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance**

Chemin Eugène-Rigot 2E

P.O. Box 1360

CH-1211 Genève 1